

Intervistë e Kryetarit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasador Osmo Lipponen, dhënë televizionit kombëtar, TV Arbëria, 6 gusht 2004.

TVA: Meqenëse jeni në fund të misionit tuaj në Shqipëri, si do ta vlerësonit rolin e Prezencës së drejtuar prej jush?

HoP: Do të ngurroja të jepja një vlerësim për atë që ka të bëjë me punën time. Mund të duket edhe si konflikt interesash, por kjo është mënyra finlandeze e të menduarit. Megjithatë, nëse duhet ta bëj, them se OSBE-ja në Shqipëri ka sot një rol shumë të mirë konstruktiv në ndryshimet pozitive dhe bashkëpunimin me aktorët ndërkombëtarë. Aktivitetet tona kanë qenë të suksesshme e, në fusha kyçe, kemi qenë të efektshëm. Jemi të efektshëm në çështje zgjedhore, çështjet e shtetit të së drejtës, pronave dhe bashkëpunimit me Kuvendin. Prezenca është në formë të mirë dhe ka shumë ekspertizë. Në të ardhmen, ajo mund t'i japë mbështetje Kuvendit, Qeverisë, shoqërisë civile dhe bashkësisë ndërkombëtare.

TVA: Cilat janë arritjet dhe mosarritjet e Prezencës së OSBE-së gjatë kësaj kohe në Tiranë?

HoP: Nuk shoh mosarritje. Kemi qenë shumë frytdhënës në fusha që nuk shihen në publik. Raporti për Sistemin Ligjor që publikuam në fillim të këtij viti është një arritje madhore dhe veprimet e fundit të Qeverisë kanë qenë në këtë linjë. Procesi i mbrojtjes së dëshmitarëve ka nisur dhe po shkon drejt një legjislacioni të frytshëm. Pavarësisht nga ndonjë kritikë nga cilido krah, ne jemi parë si partner i mirë bashkëpunues dhe kjo po funksionon me qeverinë apo shoqërinë civile. Nëse nuk kemi arritur sukses në diçka, kjo është se nuk kemi arritur të ndryshojmë mendimin se Prezenca është një gjë negative në këtë vend, ose është pjesë e mendimit që shkon mbrapa. Shumë njerëz e lidhin Prezencën në Shqipëri me periudha krize e negative, por roli i saj nuk është i tillë. Ne shihemi nga disa politikanë si organ monitorues. Në të vërtetë, ne nuk kemi një aktivitet të tillë. Nëse jemi përfshirë në një çështje që nuk ka shkuar deri në fund, kemi pasur bashkëfajtorë, por, në fund, ne kemi përgjegjësinë tonë. Zakonisht, përgjegjësia kryesore është e aktorëve politikë. Arritja më e mirë do të ishte besimi i vërtetë i njerëzve e, pavarësisht nga sulmet sporadike, ne jemi parë si forcë asnjëherë në kontributin tonë.

TVA: Marrëdhëniet tuaja me krahët e politikës në vend?

HoP: Forcat politike përpiqen të bëjnë politikë duke përdorur shpesh Prezencën si mjet në diskutimet e brendshme. Nuk mund të flasim për dy krahë si dy krahë të bashkuar, sepse, brenda koalicionit qeveritar dhe atij të opozitës, ka një ylber mendimesh e qëndrimesh. Reagimet e tyre varen nga çështja në diskutim. Por lidhja jonë është shumë e qëndrueshme, ne kemi parimim që diskutojmë me të gjitha forcat. Tensioni për të cilin media po raporton nuk duket se ka të bëjë me realitetin. Pak ditë më parë, kisha një takim shumë të frytshëm me zëvendëskryeministrin, por media raportoi se m'u dha bileta për të lënë vendin.

TVA: Pse marrëdhëniet u acaruan papritur me Socialistët për çështjen e pronave?

HoP: Në këtë pikë, nuk ishte çështja e pronave themelore. Procesi ishte shumë i mirë dhe të gjitha partitë ishin konstruktive. Do të donim një konsensus sa më të madh, por përfundimi në Kuvend nuk shkoi në këtë stil. Unë u shpreha, Z. Ruçi u shpreh gjithashtu. Ky nuk është një diskutim mes nesh dhe qeverisë, por një diskutim politik. Me qeverinë dhe ministrat, marrëdhënia vazhdon normalisht. Për shkak të kësaj situatë, çdo takim së fundi nis me referencën “Qeveria vlerëson rolin e Prezencës në Shqipëri”.

TVA: Si e shpjegoni kërkesën e Neritan Cekës me parrullën “Lipponen Go Home!”, kur u rihapën problemet e reformës zgjedhore.

HoP: Nuk do t’i jap Z. Ceka kënaqësi duke komentuar. Ai gëzon liritë qytetare për të bërë këto deklarata.

TVA: Si e shikoni situatën e tanishme parazgjedhore? Sa të rëndësishme janë zgjedhjet parlamentare për Shqipërinë? Si po ecet me reformën zgjedhore dhe çështjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)?

HoP: Më duket se përsëris veten për këto zgjedhje. Janë me rëndësi kyçe. Është e nevojshme që të mbahen zgjedhje të lira dhe të drejta, në mënyrë që të ruhet besimi në vend dhe ai ndërkombëtar për demokratizimin e Shqipërisë. Nuk jemi të vetmit që kemi këtë mendim. Ai është shfaqur nga të gjithë aktorët ndërkombëtarë. Reforma zgjedhore është më në fund duke ecur. Grupi i Ekspertëve i ka dërguar raportin e parë Komisionit Parlamentar. Është qesharake që edhe këto rekomandime të ekspertëve janë etiketuar si të OSBE-së, si shkelje të Kushtetutës. Ekspertët po punojnë me profesionalizëm të lartë, megjithë opinionet e ndryshme. Ndryshe nga ç’është thënë në media nga disa politikanë, mesazhi për KQZ-në vjen jo nga OSBE-ja, por nga rekomandimet e ODIHR-it dhe Këshillit të Evropës. Qeveria dhe opozita janë angazhuar plotësisht për këto rekomandime. Ekspertët kanë dhënë propozimet e para për KQZ-në. Do të varet nga Kuvendi vendimi për këtë. OSBE-ja, si çdo organizatë tjetër, mund të bëjë rekomandime, por nuk mund të marrë vendime apo të japë urdhra. Përgjegjësia apo vendimmarrja i takon Kuvendit Shqiptar. Do të doja që edhe atje të ishte e njëjta frymë si në grupin e ekspertëve. Për pakënaqësinë e partive të vogla, ne jemi shënjestra e gabuar. Ajo e duhura do të ishte partnerët e tyre në koalicion. Roli im dhe i OSBE-së është ta shtyjmë procesin me konsensus maksimal. Mbështetur në teorinë e parlamentarizmit, çdo deputet ka një votë, por jo çdo parti ka votë të barabartë.

TVA: Sa ndikuan këto acarime në largimin tuaj nga misioni në Shqipëri dhe diçka për emërimin tuaj të ri?

HoP: Aspak. Nëse largimi im është i parakohshëm, kjo është për shkak se qeveria ime i dërgon njerëzit në vende të ndryshme vetëm për dy vjet. Kjo politikë e re u miratua në fund të vitit të kaluar. Pra, më dërguan diku tjetër. Kam qenë në dijeni të këtij fakti prej një kohe të gjatë, por e kam mbajtur për vete këtë. Këto janë dy linja krejt të ndryshme. Lidhur me këtë fushatë të medias, nuk mund të them se nuk e vë re, por puna vazhdon

normalisht. Pozicioni i ri është shumë i ndryshëm dhe duhet krijuar. Çështja e parë është komuniteti finlandez në Nju Jork, brezi i tretë, i katërt dhe i pestë atje. Gjithashtu, është një rol lidhës, më pas, çështjet financiare, ndërtimi i imazhit të Finlandës. Nju Jorku është një kryeqytet i kryeqyteteve të botës, pra, një punë shumë e ndryshme.